

LOT 3-UNAZA, TIRANË
RELACIONI TEKNIK_REV02
KONTROLLI I STRUKTURAVE

INGENIUM, PF

PËRMBAJTJA

1	TË PËRGJITHSHME	6
1.1	Të përgjithshme mbi Projektin	6
1.2	Strukturat përbërëse të LOT 3	7
2	QËLLIMI I RELACIONIT TEKNIK	11
2.1	Të dhënat hyrëse	11
2.2	Njësitë e përdorura në këtë relacion teknik	11
2.3	Përshkrim i përgjithshëm i mbi-strukturës.....	11
2.4	Përshkrim i përgjithshëm i nën-strukturës.....	12
2.5	Studimet inxhinierike.....	13
2.5.1	Studimi gjeologjik-inxhinierik - Aneksi 1.....	13
2.5.2	Studimi sizmik.....	13
3	KUADRI LIGJOR DHE TEKNIK	14
3.1	Kushtet teknike të Projektimit	14
3.2	Kushtet teknike të zbatimit.....	15
3.3	Standardet e prodhimit të materialeve të ndërtimit.....	16
3.4	Referencat që janë përdorur në projektimin dhe kontrollin e strukturës	16
4	TË DHËNA PËR PROJEKTIMIN - STRUKTURAT E MBIKALIMIT	18
4.1	Para-dimensionimi - Gjeometria e mureve [ballnave]	18
4.2	M1, M2 dhe M3.....	18
4.2.1	Gjeometria e trarëve të mbikalimit	19
4.3	Durueshmëria dhe jetëgjatësia e veprës	20
4.3.1	Durueshmëria	20
4.3.2	Elementët mjedisorë që kanë ndikim në strukturë.....	20
4.3.3	Jetëgjatësia e projektuar e veprës.....	20
4.3.4	Përcaktimi i klasës së betonit	21
4.3.5	Shtresa mbrojtëse e hekurit të armimit	21
4.4	Cilësia e materialeve të ndërtimit.....	23
4.4.1	Klasa e betonit	23
4.4.2	Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C25/30 sipas SSH EN1992-1-1	24
4.4.3	Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C30/37 sipas SSH EN1992-1-1	24
4.4.4	Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C35/45 sipas SSH EN1992-1-1.....	25
4.4.5	Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C40/50 sipas SSH EN1992-1-1.....	25
4.4.6	Klasa e hekurit të armimit.....	26
4.4.7	Lakoret sforcim-deformim për hekurin B500C sipas SSH EN1992-1-1.....	26
4.5	Natyrat e veprimeve mbi strukturë.....	27
4.5.1	Veprimet mbi strukturë prej trafikut	27
4.5.2	Faktorët ψ për urat rrugore.....	27
4.6	Ngarkesat e trafikut - shpërndarja tërthore sipas seksionit të urës	28

4.6.1	Modelet e ngarkimit sipas SSH EN1992-2:2003	28
4.6.2	Llogaritja e koeficientit të shpërndarjes tërthore.....	29
4.6.3	Pesha vetjake e elementëve	49
4.6.4	Pesha vetjake e shtresave rrugore.....	49
4.6.5	Llogaritja e detajuar e veprimeve mbi strukturë - Aneksi 2.....	49
4.6.6	Veprimet termike	50
4.6.7	Veprimet gjatë zbatimit.....	50
4.6.8	Veprimet aksidentale.....	50
4.6.9	Veprimet horizontale të trafikut	50
5	LLOGARITJET STRUKTURORE	51
5.1	Situatat e projektimit.....	51
5.2	ULS- Gjendja kufitare.....	51
5.3	SLS- Gjendja shfrytëzimit [shërbyeshmërisë].....	51
5.4	Kombinimi i veprimeve	51
5.4.1	Kombinimet themelore të veprimeve: Situata projektimi të vazhdueshme dhe kalimtare.....	51
5.4.2	Kombinimi i veprimeve për situata projektuese aksidentale jo-sizmike.....	52
5.4.3	Kombinimet e veprimeve për situata sizmike projektuese	52
5.4.4	Kombinimet e veprimeve për Gjendjet Kufitare të Shërbyeshmërisë (SLS).....	52
5.5	Spektri i projektimit	53
5.6	Disa konsiderata për llogaritjet strukturore.....	54
5.7	Llogaritja e mbështetjeve anësorë të urës (ballnat)	55
6	MODELI MATEMATIK I STRUKTURËS	57
6.1	Gjendja e sforcuar e strukturës së Mureve (ballnave) M1, M2, M3.....	57
6.2	Gjendja e sforcuar e strukturës U0, U1, U2, U3, U4	61
6.3	Llogaritja e themeleve të thella të strukturave të urës (pilotat).....	65
6.3.1	Aneksi 2 - Kontrolli i sforcimeve në taban	65
6.3.2	Aneksi 3-1 - Kontrolli i transferimit të sforcimeve në pilota - Prova 1 - $L_{pit} = 25m$	65
6.3.3	Aneksi 3-2 - Kontrolli i transferimit të sforcimeve në pilota - Prova 2 - $L_{pit} = 31.5m$	66
6.3.4	Aneksi 3-3 - Forcat prerëse, Momentet dhe konstruimi i armimit të pilotave	67
6.3.5	Aneksi 4 - Përforcimi i truallit nën taban	68
6.3.6	Aneksi 5 - Sforcimet e brendshme llogaritëse në jastëkët e themeleve.....	68
7	PËRFUNDIME TË RELACIONIT TEKNIK.....	70
7.1	Strukturat përbërëse të LOT3-UNAZA	71
7.1.1	Plani i themeleve - Strukturat M1, M2 dhe M3	71
7.1.2	Plani i themeleve - Strukturat M4.....	71
7.1.3	Plani i themeleve - Strukturat M5	72
7.1.4	Plani i themeleve - Strukturat M6, M7.....	72
7.1.5	Plani i themeleve - Strukturat U0	73
7.1.6	Plani i themeleve - Strukturat U1, U2.....	74

7.1.7	Plani i themeleve - Strukturat U3, U4.....	75
8	REFERENCAT	77

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1:	Treguesit gjeometrikë të urës që lidh Strukturat M3 - U3,U4.....	12
Tabela 4.1:	Vlerat orientuese të jetëgjatësisë së projektuar - Tab. 2.1 e SSH EN1990.....	21
Tabela 4.2:	Klasat e betonit sipas ndikimeve të jashtme - Tab.E.1N e SSH EN 1992-1-1	21
Tabela 4.3:	Klasat e betonit që përdoren për nën-strukturat si edhe mbi strukturat e Mbikalimit [Nyja 4]	23
Tabela 4.4:	Klasat e betonit që do përdoren për strukturat M1, M2 dhe M3	23
Tabela 4.5:	Klasat e hekurit të armimit që do përdoret për strukturat e Mbikalimit, Nyja 4.....	26
Tabela 4.6:	Klasat e hekurit të armimit që do përdoret për strukturat Mbikalimit, Nyja 4.....	26
Tabela 4.7:	Faktorët e reduktimit ψ , sipas tabelës A2.1 të shtojcës A2 të SSH EN1990.....	28
Tabela 4.8:	Ngarkesat prej trafikut, tek Trau T-1, T-2 (T-3 = T-2), sipas SSH EN1992-2:2003	48
Tabela 4.9:	Ngarkesat e shpërndara, kN/m^2 , prej shtresave të rrugës.....	49
Tabela 4.10:	Ngarkesat e konsideruara gjatë punimeve të zbatimit.....	50

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1.1: Planimetri e përgjithshme, mbi shtrirjen e LOT 3	6
Fig. 1.2: Planimetri e përgjithshme - Strukturat e LOT 3	7
Fig. 1.3: Pjesë planimetrie - Strukturat e LOT 3 - Struktura M3	8
Fig. 1.4: Pjesë planimetrie - Strukturat e LOT 3 - Struktura M1	9
Fig. 1.5: Pjesë planimetrie - Strukturat e LOT 3 - Struktura M2	10
Fig. 2.1: Seksioni Tërthor - Ura që lidh Strukturat M3 - U3,U4	12
Fig. 3.1: Familja e Eurokodeve për projektimin e veprave ndërtimore	17
Fig. 4.1: Dimensionet në plan [majtas] dhe lartësi [djathtas] të strukturës	18
Fig. 4.2: Dimensionet në pamjen ballore të strukturës	19
Fig. 4.3: Dimensionet tërthore të Traut [një nga seksionet] të zgjedhur për mbikalimin	19
Fig. 4.4: Lakorja sforcim-deformim, C25/30	24
Fig. 4.5: Lakorja sforcim-deformim, C30/37	24
Fig. 4.6: Lakorja sforcim-deformim, C35/45	25
Fig. 4.7: Lakorja sforcim-deformim, C40/50	25
Fig. 4.8: Lakorja sforcim-deformim, B500C	26
Fig. 4.9: Ngarkimi i korsive sipas SSH EN1991-2:2003, LM1	29
Fig. 4.10: Skema e qarkullimit të korsive, ura që lidh M3 - U3,U4	29
Fig. 4.11: Ngarkimi i korsive sipas SSH EN1991-2:2003, LM1	30
Fig. 4.12: Vijat influente, Forca prerëse, Momentet, sipas gjatësisë së trarëve	30
Fig. 4.13: Vijat influente, Forca prerëse, Momentet, sipas gjatësisë së trarëve	31
Fig. 4.14: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM1, Trau T-1	33
Fig. 4.15: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM1, Trau T-2	35
Fig. 4.16: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM3, Trau T-1	37
Fig. 4.17: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM3, Trau T-2	39
Fig. 4.18: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM4, Trau T-1	41
Fig. 4.19: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit LM4, Trau T-2	43
Fig. 4.20: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit nga Grupi 5, Trau T-1	45
Fig. 4.21: Vija influente, shpërndarja tërthore, modeli ngarkimit nga Grupi 5, Trau T-2	47
Fig. 4.22: Shtresat strukturore të rrugës	49
Fig. 5.1: Risku i pritshëm sizmik, a_g , për strukturën në fjalë, $RP=475$ vjet	53
Fig. 5.2: Spektri, elastik dhe i projektimit, sipas SSH EN1998	54
Fig. 5.3: Spektri, elastik dhe i projektimit, sipas KTP-2-89	54
Fig. 5.4: Vijat influente, momentet përkulëse dhe forca prerëse	55
Fig. 5.5: Veprimet mbi strukturën M1, M2 dhe M3	55
Fig. 6.1: Modeli matematik, (majtas) nga ana e rrugës, (djathtas) nga ana e trarëve	57

Fig. 6.2: Gjendja e sforcuar, (majtas) analiza tonore e parë, (djathtas) nga veprimi i Grupit 5	57
Fig. 6.3: Gjendja e sforcuar, sipas drejtimit global 11, nga veprimi i Grupit 5.....	58
Fig. 6.4: Gjendja e sforcuar prerëse, sipas drejtimit global 12, nga veprimi i Grupit 5	58
Fig. 6.5: Gjendja e sforcuar, sipas drejtimit global 22, nga veprimi i Grupit 5.....	59
Fig. 6.6: Gjendja e sforcuar prerëse, sipas drejtimit global 23, nga veprimi i Grupit 5	59
Fig. 6.7: Gjendja e sforcuar maksimale, nga veprimi i Grupit 5.....	60
Fig. 6.8: Gjendja e sforcuar minimale, nga veprimi i Grupit 5.....	60
Fig. 6.9: Modeli matematik, nga ana e urës monolite që lidhet me mbështetjen U0	61
Fig. 6.10: Modeli matematik, nga ana e trarëve që lidhet me mbështetjen M4.....	61
Fig. 6.11: Gjendja e sforcuar, sipas drejtimit global 11, nga veprimi i Grupit 5	62
Fig. 6.12: Gjendja e sforcuar prerëse, sipas drejtimit global 12, nga veprimi i Grupit 5.....	62
Fig. 6.13: Gjendja e sforcuar, sipas drejtimit global 22, nga veprimi i Grupit 5	63
Fig. 6.14: Gjendja e sforcuar prerëse, sipas drejtimit global 23, nga veprimi i Grupit 5.....	63
Fig. 6.15: Gjendja e sforcuar maksimale, nga veprimi i Grupit 5	64
Fig. 6.16: Gjendja e sforcuar minimale, nga veprimi i Grupit 5	64
Fig. 6.17: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura M1, M2, M3.....	65
Fig. 6.18: Modelimi me elementë të fundmë (FEM) i pilotave	67
Fig. 7.1: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura M1, M2, M3	71
Fig. 7.2: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura M4.....	71
Fig. 7.3: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura M5.....	72
Fig. 7.4: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura M6, M7	72
Fig. 7.5: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura U0.....	73
Fig. 7.6: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura U1, U2.....	74
Fig. 7.7: Plani i themelit masiv dhe i pilotave, struktura U3, U4.....	75

1 TË PËRGJITHSHME

Ky Relacioni Teknik, është hartuar për të kontrolluar aftësinë dhe qëndrueshmërinë e themeleve të strukturave, të dimensionuara dhe projektuar në zbatim të kontratës me titull "Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta" - rrethrotullimi "Shqiponja", Loti 3"; lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe "BOE "Victoria Invest International" & VICTORIA INVEST" sh.p.k."

1.1 Të përgjithshme mbi Projektin

Projekti në fjalë shtrihet nga rrethrotullimi "Shqiponja" dhe deri tek mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta". Ndërsa LOT 3, subjekti i këtij dokumenti, shtrihet përkatësisht nga nënkalimi i Astirit dhe deri tek mbikalimi i "Pallatit me Shigjeta". Në vijim jepet një planimetri e përgjithshme, për të dhënë një ide mbi shtrirjen e LOT 3.




Fig. 1.1: Planimetri e përgjithshme, mbi shtrirjen e LOT 3

1.2 Strukturat përbërëse të LOT 3

Pjesë e Projektit janë edhe strukturat ku mbështeten nënkalinimet apo mbikalimet si edhe muret mbajtëse që shërbejnë për mbështetjen dhe lidhjen e niveletave me kuota të ndryshme. Në vijim jepen disa planimetri, për vendndodhjen e strukturave në LOT 3.




Fig. 1.2: Planimetri e përgjithshme - Strukturat e LOT 3




Fig. 1.3: Pjesë planimetrie - Strukturat e LOT 3 - Struktura M3




Fig. 1.5: Pjesë planimetrie - Strukturat e LOT 3 - Struktura M2

2 QËLLIMI I RELACIONIT TEKNIK

Ky raport prezanton në mënyrë të përmbledhur qasjen që është ndjekur për projektimin dhe kontrollin e themeleve të nën-strukturave si edhe mbi strukturat e Mbikalimit [Nyja 4].

2.1 Të dhënat hyrëse

Nga Sipërmarrësi, referuar pikës 1, për projektimin dhe kontrollin e qëndrueshmërisë së themeleve të këtyre elementëve strukturorë u përdorën të dhënat e mëposhtme:

1. Plan vendosja e mbikalimit;
2. Studimin Gjeologo - Inxhinierik - Aneksi 1 [pjesë integrale e këtij Relacioni Teknik];
3. Rilevimin topografik;
4. Gjeometrinë dhe dimensionet e trarëve të pasnderur, që lidhin Ballnat M me Urën U;
5. Cilësinë e materialeve të ndërtimit [klasa e Betonit dhe e Hekurit të armimit];

Sipas eksperiencave më të mira inxhinierike, dhe nevojshmërisë për të rikonfirmuar vlerat e përfutuara nga studimi Gjeologo-Inxhinierik të parametrave fiziko-mekanike të dherave, përpara çdo punimi të mëtejshëm gjeoteknik, rekomandojmë që të ri-verifikohen saktë parametrat e shtresave gjeologjike ekzistuese përkundrejt parametrave të shtresave të marra në projekt.

2.2 Njësitë e përdorura në këtë relacion teknik

Sistemi i njësive i përdorur në llogaritjet, kontrollet dhe projektimin e strukturave është sistemi S.I. Më poshtë jepen njësitë që janë përdorur:

- | | |
|---------------------------------|--|
| ▪ Veprimet dhe Ngarkesat | kN, kN/m, kN/m ² ; |
| ▪ Densiteti dhe masa | kg/m ³ , t/m ³ kg, t; |
| ▪ Pesha njësi (Pesha specifike) | kN/m ³ ; |
| ▪ Sforcimet dhe presioni | N/mm ² (= MN/m ² ose MPa), kN/m ² (=kPa); |
| ▪ Momentet | kN·m; |
| ▪ Nxitimi i trullit | m/s ² , g (= 9,81 m/s ²); |

2.3 Përshkrim i përgjithshëm i mbi-strukturës

Bazuar në planimetrinë e përgjithshme të zgjidhjes së propozuar, për zhvillimin si në lartësi ashtu edhe në plan të segmentit LOT3-Unaza, në rilevimin topografik të zonës, në funksion të parametrave gjeometrikë të rrugës, por edhe përkundrejt kërkesave për të plotësuar nevojat e qarkullimit u pranua që mbi-kalimi të ishte i përbërë nga disa struktura të dallueshme nga njëra tjetra. Konkretisht, këto struktura përbëhen nga Ballnat me indeksin M, Rampat ngjitëse/zbritëse me indeksin R, si edhe Urën kryesore me indeksin U [shih Fig. 1.2]. Kjo urë, ka hapësirë drite $H_D=32.3$ m. Ky variant konsiston në ndërtimin e një ure ku mbështetjet anësore do të përbëhen nga ballna betonarme të mbështetur në pilota të cilat do të mbështeten në shtresën numër 5,. Ky detaj jepet në vizatime ashtu edhe në studimin gjeologjik.

Detaje më të hollësishme të llogaritjeve strukturale jepen në kapitujt e mëposhtëm të këtij dokumenti. Ura ka veçoritë e mëposhtme:

- a) Urë me hapësirë dritë prej 32.3 metra;
- b) Mbi-strukturë e përbërë nga trarë beton-arme në formë T-je;
- c) Seksion tërthor me 6 trarë të baraslarguar midis tyre në drejtimin tërthor 1.98 m [i ndrysshueshëm];
- d) Nën-strukturë me ballna betonarme të derdhur në vend të mbështetur mbi pilota.

Mbi-struktura e urës përbëhet nga 6 trarë b/a të vendosur simetrisht ndaj aksit të urës dhe që në drejtimin tërthor lidhen me diafragma b/a. Distanca ndërmjet trarëve është 1.98 m. Mbi pjesën e sipërme të trarëve dhe soletës vendosen shtresat e urës siç jepen në detajin e shtresave. Në mbështetjet

e urës do të ketë fugë [prej deformimit ndaj temperaturave, apo prej zhvendosjeve që vinë nga ngarkesat horizontale që veprojnë në urë] siç tregohet në vizatime.

Më poshtë jepet seksioni tërthor i urës, që i përket urës që lidh M3 me U3-U4.




Fig. 2.1: Seksioni Tërthor - Ura që lidh Strukturat M3 - U3,U4

Më poshtë jepen në mënyrë tabelore disa nga treguesit gjeometrikë të urës:

Tabela 2.1: Treguesit gjeometrikë të urës që lidh Strukturat M3 - U3,U4

Përshkrimi i treguesit gjeometrik	Simboli	Madhësia	Njësia
Gjerësia totale e seksionit tërthorë të urës	W_{TOT}	12.5	m
Gjerësia e karrexhatës	$W_{KARREXHATA}$	11.7	m
Gjerësia e korsisë (vijë kalimi)	W_{KORSI}	3.5	m
Gjerësia e bankinës	W_{BAN}	0.4	m
Hapësira ndërmjet trarëve	d	1.98	m

2.4 Përshkrim i përgjithshëm i nën-strukturës

Mbështetjet anësore të urës janë parashikuar të bëhen me ballna b/a, pra strukturat M1, M2, M3 dhe M4 dhe lidhen me trarët e pasnderur me boksën b/a të strukturës U1-U2 dhe U3-U4. Ballnat, janë projektuar si elementë masivë b/a, që mbështeten direkt në jastëk me pilota [vlen të theksohet që ky vendim është marrë në fund të procesit llogaritës strukturor, pas disa variantesh dhe tentativash] të cilat transmetojnë ngarkesën vertikale në formacionin bazë [shtresa 5, sipas studimit gjeologo-inxhierik].

Këto zgjedhje dhe saktësime gjeometrike janë bazuar në faktin që forma dhe dimensionet, si edhe tipi i themeleve të pranuar sigurojnë qëndrueshmërinë e ballit kundrejt të gjitha varianteve të

ngarkimeve sipas EN1990 dhe EN1991 [si edhe pjesët e tyre përkatëse]. Në të dyja anët e ballnës vendosen muret anësore [ose anglisht - Wingwalls] që bëjnë të mundur mbajtjen dhe qëndrueshmërinë e mbushjes mbi të cilën mbështetet edhe soleta e përafrimit [anglisht - approach slab].

Muret anësore do të ndërtohen si mure mbajtëse b/a dhe kanë lartësi të ndryshueshme në funksion të relievit. Në pjesën e pasme të ballnës vendoset soleta përafruese, për të parandaluar uljet mbi ato të lejuarat në hyrjen e urës, si nga ana e strukturës M3 ashtu edhe nga ana e strukturës U3.

Mbi ballna do të mbështeten trarët e urës, të cilët do të mbështeten mbi neoprenë (shembull konkret i një kompanie të certifikuar CE është MAURER SE, maurer.eu ose një tjetër kompani që prodhon një produkt ekuivalent të certifikuar). Mbështetjet e neoprenit do të zgjidhen të atilla që të lejojnë zhvendosjen maksimale horizontale të mundshme, brenda kufijve të lejuar, në mënyrë që mos të cenohet fuga e urës. Në pjesën ku mbi-strukturat mbështeten tek ballnat, do lihet një kanal anësor përgjatë gjithë gjërësisë së ballnës që do të shërbejë për largimin e ujërave të shiut.

2.5 Studimet inxhinierike

2.5.1 Studimi gjeologjik-inxhinierik - Aneksi 1

Për analizën strukturore, është marrë parasysh edhe studimi gjeologo-inxhinierik. Ai është kryer nga NORD COMAT sh.p.k., i cili thekson se objekti është i vendosur në një pakete dherash me shtresa me parametra të ndryshme gjeo-teknikë. Më tutje në këtë dokument, do referohet me përshkrimin Aneksi 1.

Parametrat e këtij studimi janë marrë parasysh në llogaritjet dhe kontrollet e themeleve të strukturave, qëllimi i këtij relacioni teknik, dhe janë pjesë përbërëse e këtij relacioni pasi parametrat gjeo-teknikë janë të dhënat hyrëse kryesore për kontrollin e qëndrueshmërisë dhe përmasimin themeleve.

2.5.2 Studimi sizmik

Për analizën strukturore të kësaj strukture, është marrë parasysh edhe rajonizimi sizmik. Sipas studimeve, dhe hartës në fuqi për rajonizimin sizmik, theksohet se sheshi i ndërtimit në studim klasifikohet si truall i kategorisë të II-të sipas KTP-N2-89, dhe si truall i tipit B sipas SSH EN-1198-1 (2004). Nxitimi maksimal në shkëmbin bazë të këtij sheshi ndërtimi rezulton $a_{g,max}=0.290g$.

3 KUADRI LIGJOR DHE TEKNIK

Më poshtë jepet kuadri ligjor teknik i plotë në fuqi (është detyrë e zbatuesit të kontrollojë nëse standardet e prodhimit të materialeve të ndërtimit si edhe kushtet teknike të zbatimit të listuara, kanë pësuar ose jo, ndryshime apo përditësime) përsa u përket të tria fazave të realizimit të veprës. Vlen të theksohet, që kjo listë shërben edhe si udhëzues për të gjitha palët e përfshira në realizimin e veprës, mbi standardet dhe normativat mbi veprat ndërtimore, por jo domosdoshmërisht ndonjë rregull apo ndonjë pjesë e secilës tyre është dashur të përfshihet në formulimin dhe realizimin e llogaritjeve të këtij raporti teknik. Më poshtë jepet e plotë, lista e standardeve të prodhimit të materialeve të ndërtimit, e kushteve teknike të zbatimit si edhe kushtet teknike të projektimit.

3.1 Kushtet teknike të Projektimit

- SSH EN 1990 së bashku me Aneksin A1; - Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor;
- SSH EN 1991 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 1: Veprimet mbi veprat ndërtimore;
- SSH EN 1992 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 2: Projektimi i veprave ndërtimore prej betoni apo betoni të armuar;
- SSH EN 1993 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 3: Projektimi i veprave ndërtimore prej çeliku;
- SSH EN 1994 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 4: Projektimi i veprave ndërtimore të përbëra prej çeliku dhe betoni;
- SSH EN 1996 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 6: Projektimi i veprave ndërtimore me muraturë;
- SSH EN 1997 së bashku me të gjitha pjesët; - Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik i veprave ndërtimore;
- SSH EN 1998 së bashku me pjesët 1,2,3,4,5,6; - Eurokodi 8: Bazat e projektimit strukturor
- Kriteria projektimi e ndërtimi në zona sizmike (KTP 2-78).
- Kriteria projektimi. Klasifikimi i veprave ekonomike e shoqërore (KTP 3-78).
- Kriteria projektimi. Klasifikimi i dherave joshkëmbore që shërbejnë si bazament për veprat inxhinierike (KTP 5-78).
- Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesave në objektet shoqërore ekonomike (KTP 6-78).
- Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së erës (KTP 7-78).
- Kriteria projektimi. Përcaktimi i ngarkesës së borës (KTP 8-78).
- Kriteria projektimi. Llogaritja e mureve dhe themeleve me teorinë e gjendjes kufitare. (KTP 9-78).
- Kriteria projektimi për rrugët automobilistike (KTP 22-78).
- Kriteria projektimi për urat e tombinat prej betoni dhe beton armeje në rrugët automobilistike (KTP 23-78).
- Udhëzime teknike projektimi. Mbi përmbajtjen e projekteve sipas fazave të projektimit të veprave të ndërtimit.
- Simbolet në llogaritjen e konstruksioneve të ndërtimit.
- Standardet e "Paraqitjes grafike të projekteve dhe simbolet në Vizatimet e Ndërtimit".
- Metodika e përcaktimit soliditetit të dherave në shtypje njëboshtore.
- Udhëzuesi i studimeve gjeologo-inxhinierike për ura, viadukte mbikalime e nënkalime hekurudhore.
- Mbi ngarkesat dhe veprimet në rrugët automobilistike.
- Mbi-struktura dhe nën-struktura prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat e artit rrugore dhe hekurudhore (përfshirë dhe çernierat).
- Konstruksione prej betoni dhe betoni të armuar në veprat hidroteknike me teorinë e gjendjes kufitare.
- Vlerësimi i agresivitetit të ujit natyror, nëntokësor dhe sipërfaqësor.

- Llogaritja e konstruksioneve prej betoni dhe betoni të armuar të zakonshëm në veprat ekonomike dhe shoqërore me teorinë e gjendjes kufitare.
- Llogaritja e konstruksioneve b/arme të paranderur në veprat ekonomike dhe shoqërore.
- Projektimi i veprave të artit, rrugore dhe hekurudhore prej betoni dhe beton armeje të zakonshme.
- Studime gjeologo-inxhinierike për projektimin e veprave ekonomike.
- Përcaktimi i vetive fizike të dherave me metoda laboratorike.
- Përcaktimi i vetive gjeoteknike të dherave presiometër.
- Kushte teknike projektimi të bazave e themeleve të objekteve inxhinierike me gjendjen kufitare.

3.2 Kushtet teknike të zbatimit

- Zbatim punimesh. Kushte të përgjithshme për zbatimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtim – montimit (KTZ 01-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të gërmimit dhe të mbushjes në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 2-78).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të themeleve për makineritë (KTZ 3-76).
- Zbatim punimesh themele. Mure me tulla. Të dhëna ndërtimi (KTZ 5-79).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni dhe beton/armeje në veprat hidroteknike (KTZ 7-81).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të hidroizolimit në ndërtesat qytetare, industriale e bujqësore (KTZ 9-79).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni dhe betonarmeje në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore. Strukturat monolite (KTZ 10/1-78).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e strukturave prej betoni e betonarmeje në veprat industriale qytetare e bujqësore. Struktura të papërgatitura (KTZ 10/2-78).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve prej betoni dhe betonarmeje në veprat industriale, qytetare dhe bujqësore. Struktura të paranderura (KTZ 10/3-78).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të karpenterisë dhe zdrukthëtarisë me dru në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 16-79). Rishikimi : 1985
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për ndërtimin e dyshemeve në ndërtesat industriale, qytetare dhe bujqësore (KTZ 17-79). Rishikuar : 1985
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e skelave me tuba çeliku (KTZ 19-79). Rishikimi : 1985
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të konstruksioneve metalike (KTZ 21-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pilota (KTZ 22-81).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për përfundimin e rrjetit të jashtëm të ujësjellësve dhe kanalizimeve (KTZ 28-81).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike, pjesa e përgjithshme (KTZ 28-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike me përcjellës (KTZ 29-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike. Montimi i linjave kablllore (KTZ 30-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike, instalimet e tokëzimit (KTZ 31-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve elektrike (KTZ 32-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të shtresave në rrugë, autostradë, etj. (KTZ 38-81)
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pilota UKS (KTZ 39-81).
- Kushte teknike të zbatimit të punimeve të montimit të pajisjeve elektrike në nënstacionet elektrike (KTZ 42-82).
- Kushte teknike të shmangieve të lejuara në ndërtim-montim (KTZ 49-89).

- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve për saldimin e çeliqueve inoksidabël në veprat industriale (KTZ 206-80).
- Zbatimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të montimit të makinave metal punuese (KTZ 228-81).

3.3 Standardet e prodhimit të materialeve të ndërtimit

- SSH 543 : 1987 Tulla silikate të plota
- SSH 551 : 1987 Gurë gëlqerorë për muraturë
- SSH 2505 : 1987 Tulla të plota prej argjile
- SSH 2572 : 1987 Tulla argjili me veshë dhe tulla dekorative
- SSH 511 : 1987 Çimento
- SSH 562 : 1987 Betone hidroteknike. Klasifikime dhe kërkesat cilësore
- SSH 564 : 1987 Betone të zakonshëm. Kërkesat cilësore për materialet përbërëse
- SSH 571 : 1987 Betone të zakonshëm. Klasifikime dhe kërkesat cilësore
- SSH 104 : 1988 Panele të ndryshme betonarme, plinta betoni e b/arme për bujqësinë
- SSH 199 : 1988 Traversa dekovili të paranderura betonarme
- SSH 200 : 1988 Shtylla e kapele të zakonshme e të paranderura betonarme
- SSH 507 : 1988 Blloqe betoni
- SSH 535 : 1988 Penale betonarme me vrima të zakonshme
- SSH 545 : 1988 Shtylla të centrifuguara betonarme
- SSH 552 : 1988 Panele të mëdha të parapërgatitura betonarme për mure, dysHEME dhe elementë të tjerë
- SSH 553 : 1988 Prodhime të parapërgatitura betoni e betonarme të zakonshme e të paranderura. Kërkesat cilësore
- SSH 558 : 1988 Panele betonarme govate për mbulimin e ndërtesave industriale
- SSH 2765 : 1998 Kolona të parapërgatitura betonarme
- SSH 2766 : 1988 Trarë betonarme të parapërgatitura
- SSH 2769 : 1988 Pilota të parapërgatitura betonarme
- SSH 2851 : 1988 Soleta të paranderura betonarme
- SSH 2852 : 1998 Kapriata të paranderura betonarme
- SSH 2853 : 1988 Arkitrarë betonarme të parapërgatitura me dhe pa ngarkesë
- SSH 2859 : 1988 Panele të paranderura betonarme me 2 dhe 3 vrima
- SSH 3156 : 1988 Trarë me qeramikë të armuar
- SSH ENV 206 : 1997 Betoni, vetitë, prodhimi, përpunimi dhe kriteret e përshtatshmërisë
- SSH 501 : 1987 Çimento: Karakteristikat

3.4 Referencat që janë përdorur në projektimin dhe kontrollin e strukturës

Për llogaritjet dhe kontrollet strukturore u shfrytëzuan:

- Kushtet Teknike të Projektimit (KTP);
- Normat Evropiane të projektimit, familjet e Eurokodeve, duke u përqendruar tek pjesët ku zgjidhen dhe trajtohen çështjet e modelimit struktural, llogaritjes dhe kontrolleve.

Skematikisht, në figurën e mëposhtme, tregohet rendi sesi duhet të përdoren Eurokodet, mënyra sesi mund të nxirret dhe përdoret informacion prej tyre, si edhe radha e marrjes parasysh të rregullave të projektimit të veprave ndërtimore.




Fig. 3.1: Familja e Eurokodeve për projektimin e veprave ndërtimore

4 TË DHËNA PËR PROJEKTIMIN - STRUKTURAT E MBIKALIMIT

Përpara se të zhvillojmë detajet gjeometrike, materialet dhe kontrollet e tyre, vlen për tu theksuar që gjeometria e këtyre strukturave, është para-dimensionuar me përmasa që janë të pritshme për këto natyra strukturash dhe që janë propozuar në fazën e parë të projektit paraprak.

Këto struktura, janë pranuar të kenë të njëjtën gjeometri dhe dimensione. Ky pranim, është bazuar në numrin e njëjtë të trarëve që mbështeten në to, në tabanin e njëjtë që ato mbështeten, dhe si rrjedhojë ato janë të ngarkuara dhe të sforcuara njësoj. Kontrollat që vijnë shtjellojnë të gjitha hapat për të bërë verifikimet e nevojshme nëse themelet e tyre janë të mjaftueshme për të transmetuar me sukses ngarkesat në taban.

4.1 Para-dimensionimi - Gjeometria e mureve [ballnave]

4.2 M1, M2 dhe M3

Për shkak të ngarkesave të mëdha që pritet të shkarkohen në këto struktura, para-dimensionimi është konceptuar sipas formës së pritshme të ballnave të urave Gjeometria dhe dimensionet në plan dhe lartësi të kësaj strukture janë dhënë më poshtë:




Fig. 4.1: Dimensionet në plan [majtas] dhe lartësi [djathtas] të strukturës

Për të dhënë një ide më të qartë se si mbështeten trarët e urës, më poshtë jepet figura për dimensionet e pamjes ballore të mureve të kësaj strukture.




Fig. 4.2: Dimensionet në pamjen ballore të strukturës

4.2.1 Gjeometria e trarëve të mbikalimit

Për të përfunduar llogaritjet, kontrollin e qëndrueshmërisë të vetë kësaj strukture si edhe të themeleve të saj, ka qenë e nevojshme vënia në dispozicion e informacionit të nevojshëm mbi gjeometrinë e trarëve.

Sipërmarrësi, i referuar në pikën 1, ka vënë në dispozicion traun e përzgjedhur për t'u përdorur në këtë mbikalim. Vlen për t'u theksuar, se kontrolli, dimensionimi dhe konstruimi [apo armimi] i këtyre trarëve nuk bën pjesë tek dhe nuk është qëllimi i këtij Relacioni Teknik [ky dokument], dhe gjeometria e tyre është pranuar ashtu siç është vënë në dispozicion nga Sipërmarrësi. Gjeometria e traut që do përdoret, jepet më poshtë:

SEKSIONI TËRTHOR I TRAUT NË MBËSHTETJE




Fig. 4.3: Dimensionet tërthore të Traut [një nga seksionet] të zgjedhur për mbikalimin

4.3 Durueshmëria dhe jetëgjatësia e veprës

4.3.1 Durueshmëria

Një strukturë duhet të plotësojë kërkesat e shërbyeshmërisë, e rezistencës ndaj veprimeve si edhe atyre të qëndrueshmërisë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së saj për të cilën është projektuar. Kërkesat për mbrojtjen e strukturës përcaktohen duke marrë parasysh përdorimin e synuar të saj, jetëgjatësinë e saj për të cilën është projektuar, por edhe natyrën e veprimeve kryesore që ushtrojnë ndikimin e tyre vazhdimisht mbi strukturë.

Një nga kërkesat themelore për mbrojtjen e strukturës, është mbrojtja e shufrave të hekurit të armimit apo elementëve prej çeliku ndaj gërryerjes. Plotësimi i kësaj kërkesë varet nga pesha volumore e betonit të përdorur, klasa e betonit, trashësia e shtresës mbrojtëse, madhësia maksimale e pranuar e plasaritjeve në beton. Në paragrafët e mëposhtëm, jepen të detajuara pranimet që janë bërë për kënaqur këto kërkesa.

4.3.2 Elementët mjedisorë që kanë ndikim në strukturë

Elementët mjedisorë që kanë ndikim në strukturë klasifikohen sipas Tabelës 4.1 të SSH EN 1992-1-1, e cila bazohet në EN 206-1. Sipas tabelës së sipërpërmendur, elementët e veprave të artit ky bëjnë pjesë edhe strukturat subjekt i këtij relacioni, në raport me ndikimin e fenomenit të gërryerjes i takojnë klasave:

- XC1 E thatë ose vazhdimisht e lagësht;
- XC2 E lagësht dhe rrallë herë e thatë, Betoni shpeshherë është në prani të ujit. Themele;
- XC4 E thatë dhe e lagësht në mënyrë ciklike: Sipërfaqe betoni që janë në prani të ujit, por që nuk bëjnë pjesë në klasën e ekspozimit XC2.

Gjithsesi, duke marrë parasysh veçoritë e trupave ujqorë përreth vendndodhjes aktuale të veprës, janë marrë parasysh edhe klasat e mëposhtme të ekspozimit, të cilat kanë të bëjnë me dëmtimet e mundshme të betonit.

- XA1 Mjedis kimik pak agresiv, sipas SSH EN 206-1, Tabela 2;
- XF1 Ngopje mesatare me ujë, pa agjentë kundër ngrirjes (ndikimi ngrirje/shkrirje).
- XF2 Ngopje mesatare me ujë, pa agjentë kundër ngrirjes (ndikimi ngrirje/shkrirje).

Sipas SSH EN 1992-1, 4.4.1.2(12): Në ato raste kur ciklet ngrirje/shkrirje ose mjedisi kimik pritet të ketë ndikim mbi betonin (klasat XF dhe XA), rekomandohet që t'i kushtohet vëmendje e veçantë recetës së betonit (shih SSH EN 206-1 Seksioni 6). Zakonisht, shtresa mbrojtëse në përputhje me rekomandimin e 4.4, është e mjaftueshme për situata të tilla projektuese.

Është detyrim i sipërmarrësit, që të bëjë analizat e ujërave nëntokësore si edhe të ajrit, për të vlerësuar përbërjen kimike të tyre. Mbi bazën e këtyre të dhënave, duhet të gjykohet mbi shkallën reale të aktivitetit kimik mbi strukturë dhe në përputhje me gjetjet e analizave kimike, duhet të shtohen në beton elementët kimik mbrojtës.

4.3.3 Jetëgjatësia e projektuar e veprës

Jetëgjatësia për të cilën duhet projektuar një vepër e kësaj natyre, është përcaktuar duke u bazuar në SSH EN 1990. Përkufizimi i saj shprehimisht është: "periudha gjatë së cilës pritet se një strukturë, ose pjesë të saj, përdoret për qëllimin e synuar, duke e kryer mirëmbajtjen e parashikuar, por pa pasur të domosdoshme riparime të mëdha". Jetëgjatësia për të cilën duhet projektuar një vepër duhet të zgjidhet

siç është e nevojshme në harmoni me veprimet e projektimit (p.sh. verimet sizmike), karakteristikat e materialeve (p.sh. lodhja e materialeve), zhvillimi e strategjisë së mirëmbajtjes, etj.

Bazuar në tabelën e mëposhtme, jetëgjatësia e pranuar e projektimit për strukturat në fjalë është 100 vjet.

Tabela 4.1: Vlerat orientuese të jetëgjatësisë së projektuar - Tab. 2.1 e SSH EN1990

Kategoritë e jetëgjatësisë së projektuar	Vlerat treguese të jetëgjatësisë (në vjet)	Shembuj kur zbatohet
1	10	Struktura të përkohshme
2	10 ÷ 25	Pjesë të zëvendësueshme të strukturave p.sh. trarë urash, mbështetjet e urave etj.
3	15 ÷ 30	Struktura bujqësore dhe struktura të ngjashme
4	50	Struktura banimi dhe struktura të tjera të zakonshme
5	100	Struktura monumentale, urat dhe struktura të tjera të inxhinierisë civile

4.3.4 Përcaktimi i klasës së betonit

Përcaktimi i duhur i klasës së betonit, dhe që të jetë sa më jetëgjatë, bëhet duke patur parasysh mbrojtjen e betonit nga agentët e ndryshëm të jashtëm si edhe mbrojtjen e hekurit të armimit apo elementëve të çelikut nga gërryerjet. Natyrisht kjo zgjedhje bëhet në harmoni edhe me recetën apo përbërjen e betonit. Për klasat e ekspozimit të treguara me lart, dhe në përputhje me Tabelën E.1N në SSH EN 1992.1.1, është përcaktuar klasa minimale e betonit siç tregohet më poshtë.

Tabela 4.2: Klasat e betonit sipas ndikimeve të jashtëme - Tab.E.1N e SSH EN 1992-1-1

Klasat e ekspozimit në përputhje me Tabelën 4.1										
Gërryerja										
	Gërryerje e shkaktuar nga karbonizimi				Gërryerje e shkaktuar nga kloruri			Gërryerje e shkaktuar nga kloruri i ujit të detit		
	XC1	XC2	XC3	XC4	XD1	XD2	XD3	XS1	XS2	XS3
Klasa e betonit	C20/25	C25/30	C30/37		C30/37		C35/45	C30/37	C35/45	
Dëmtimet në beton										
	Nuk ka rrezik		Ciklet Ngrirje/Shkrirje			Sulmi kimik				
	X0		XF1	XF2	XF3	XA1	XA2		XA3	
Klasa e betonit	C12/15		C30/37	C25/30	C30/37	C30/37			35/45	

4.3.5 Shtresa mbrojtëse e hekurit të armimit

Shtresa mbrojtëse minimale duhet të përmbushë dy kërkesa:

1. lidhjen e hekurit të armimit me betonin;
2. durueshmërinë.

Shprehur sipas kërkesave të SSH EN1992-1-1:

$$c_{\min} = \max \{c_{\min,b}; c_{\min,dur}; 10 \text{ mm}\}$$

ku: $c_{\min,b}$ shpreh kërkesën e lidhjes së hekurit të armimit me betonin, e cila jepet në Tab. 4.2 të SSH EN 1992-1-1 sipas shprehjes (në mm) $c_{\min,b} = : \max \{\Phi_{bl}; \text{agg}\}$.

Në rastin tonë, vlera e $c_{\min,b}$ është: 30 mm.

Ndërsa, $c_{\min,dur}$ sipas SSH EN1992-1-1, jepet në Tab. 4.4N, në varësi të:

- a) klasës së ekspozimit (Tab. 4.1);
- b) klasës strukturore (Tab. 4.3N).

Sipas zgjedhjeve të bëra më sipër, për Klasën Strukturore S5 dhe klasën e ekspozimit XC4, vlera e $c_{\min,dur}$ është 35mm.

Shtresa mbrojtëse projektuese, e cila është edhe vlera që raportohet dhe pasqyrohet në vizatime, si edhe përdoret në llogaritje, merret duke i shtuar vlerës minimale një devijim të mundshëm për shkak të defekteve të montimit në zbatim, duke garantuar që kjo vlerë minimale do të respektohet gjatë zbatimit.

$$c_{\text{nom}} = c_{\min} + \Delta_{c,\text{dev}}$$

ku: $\Delta_{c,\text{dev}} = 10\text{mm}$ (jepet si vlerë e rekomanduar në pikën 4.4.1.3 (1)P të SSH EN1992-1-1).

Përfundimisht në llogaritjet strukturore do përdoret:

- 1.** $c_{\text{nom}} = 40$ mm për mbistrukturën;
- 2.** $c_{\text{nom}} = 50$ mm për nënstrukturën.

4.4 Cilësia e materialeve të ndërtimit

4.4.1 Klasa e betonit

Bazuar në kërkesën për cilësi të lartë të materialeve, klasat e betonit të propozuara për t'u përdorur për një vepër ndërtimore të kësaj natyre, pra për nën-strukturat si edhe mbi strukturat e Mbikalimit [Nyja 4 - sipas referimit në Preventivin e kontratës], jepen në tabelën e mëposhtme. Gjithsesi në çdo rast, ashtu siç është edhe specifikuar në tabelë, klasat e betonit për çdo element strukturor do jetë sipas vizatimeve të Projektit të Zbatimit.

Tabela 4.3: Klasat e betonit që përdoren për nën-strukturat si edhe mbi strukturat e Mbikalimit [Nyja 4]

Emërtimi i klasës SSH EN1992-1-1	Elementi strukturor ku do përdoret	Shënime	Marka
C30/37	Çdo element i mbi-strukturës	Në çdo rast sipas vizatimeve	M370
C40/50	Trarët e parapërgatitur	Në çdo rast sipas vizatimeve	M500
C35/45	Pilat (këmbët e urës)	Në çdo rast sipas vizatimeve	M450
C30/37	Themelet e pilave	Në çdo rast sipas vizatimeve	M370
C30/37	Balli i urës	Në çdo rast sipas vizatimeve	M370
C30/37	Soletat	Në çdo rast sipas vizatimeve	M370
C25/30	Pilotata	Në çdo rast sipas vizatimeve	M300
C30/37	Muret mbajtëse	Në çdo rast sipas vizatimeve	M370

Më poshtë jepen në mënyrë tabelore karakteristikat fiziko-mekanike të klasave të ndryshme të betonit sipas SSH EN1992-1-1.

Tabela 4.4: Klasat e betonit që do përdoren për strukturat M1, M2 dhe M3

Klasa	$f_{ck,cilindrike}$ (MPa)	$f_{ck,cube}$ (MPa)	γ_c	$f_{cd,cilindrike}$ (MPa)	f_{cm} (MPa)	f_{ctm} (MPa)	ϵ_{c1} (‰)	ϵ_{cu2} (‰)	γ (kN/m ³)	E_{cm} (GPa)
C25/30	25	30	1.5	16.67	33	2.6	2.1	3.5	25	31
C30/37	30	37	1.5	20	38	2.9	2.2	3.5	25	33
C35/45	35	45	1.5	23.33	43	3.2	2.25	3.5	25	34
C40/50	40	50	4.5	26.67	48	3.5	2.3	3.5	25	35

4.4.2 Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C25/30 sipas SSH EN1992-1-1




Fig. 4.4: Lakorja sforcim-deformim, C25/30

4.4.3 Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C30/37 sipas SSH EN1992-1-1




Fig. 4.5: Lakorja sforcim-deformim, C30/37

4.4.4 Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C35/45 sipas SSH EN1992-1-1




Fig. 4.6: Lakorja sforcim-deformim, C35/45

4.4.5 Lakoret sforcim-deformim për klasën e betonit C40/50 sipas SSH EN1992-1-1




Fig. 4.7: Lakorja sforcim-deformim, C40/50

4.4.6 Klasa e hekurit të armimit

Bazuar në kërkesën për cilësi të lartë të materialeve, klasa e hekurit (periodik) të armimit të propozuar për t'u përdorur për një vepër ndërtimore të kësaj natyre, pra strukturat e Mbikalimit, është zgjedhur të ketë aftësi të lartë të plasticitetit (duktiliteti) jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4.5: Klasat e hekurit të armimit që do përdoret për strukturat e Mbikalimit, Nyja 4

Emërtimi i klasës SSH EN1992-1-1	Elementi strukturor ku do përdoret
B500C	Çdo element i strukturës

Më poshtë jepen në mënyrë tabelore karakteristikat fiziko-mekanike të hekurit të armimit sipas SSH EN1992-1-1.

Tabela 4.6: Klasat e hekurit të armimit që do përdoret për strukturat Mbikalimit, Nyja 4

Klasa	f_{yk} (MPa)	f_{yd} (MPa)	γ_s	ϵ_{uk} (%)	$k=(f_t/f_y)_k$	γ (kN/m ³)	E_s (GPa)
B500C	500	434.78	1.15	7.5	3.5	78.5	200

4.4.7 Lakoret sforcim-deformim për hekurin B500C sipas SSH EN1992-1-1



Fig. 4.8: Lakorja sforcim-deformim, B500C

4.5 Natyrat e veprimeve mbi strukturë

Bazuar në SSH EN1991-1, veprimet mbi strukturë, sipas ndryshimit të madhësisë së tyre në funksion të kohës i klasifikojmë, si më poshtë:

- Veprime të përhershme (G), p.sh. peshat vetjake të strukturave, të pajisjeve të fiksuara dhe shtresave rrugore, veprime jo të drejtpërdrejta të shkaktuara nga tkurrja e betonit dhe cedimet jo të njëtrajtshme;
- Veprime të ndryshueshme (Q), p.sh. ngarkesat e ushtruara në mbi-strukturë apo në trarë;
- Veprimet e erës ose ngarkesat e dëborës;
- Veprime aksidentale (A), p.sh. veprimet sizmike, shpërthimet ose goditjet nga automjetet.

4.5.1 Veprimet mbi strukturë prej trafikut

Këto veprime janë përkufizuar në pjesë të ndryshme të Eurokodit 1 (SSH EN1991), por jepen në mënyrë të përmbledhur si:

- TS: Ngarkesa e trafikut (TS, në anglisht - Tandem System) së bashku me ngarkesën shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme (UDL, në anglisht - Uniformly Distributed Load) të trafikut. Këto dy ngarkesa përbëjnë modelin 1 të ngarkimit prej trafikut LM1 [SSH EN1991-2];
- q_{fk} ngarkesa uniforme në trotuar [SSH EN1991-2];
- g_{ri} grupi i ngarkimit "i", ky grupim jep përcaktimin e qartë të kombinimeve të ndryshme të modeleve të ngarkesës për të përfutur veprimin e njëkohshëm të tyre në strukturat [SSH EN1991-2];
- F_w Veprimi prej erës. F_w^* përfaqëson veprimin e erës në trafik dhe F_{wk} veprimin e erës në mungesë të trafiku [SSH EN1991-4];
- T Veprimi në strukturë prej temperaturës;
- Q_{Snrk} Veprimi prej borës [SSH EN1991-4];
- A_d Veprimet aksidentale;
- A_{Ed} Veprimet sizmike;
- P një simbol i përgjithshëm, që përfaqëson paranderjen si një vlerë të mundshme ose si vlerë karakteristike;

4.5.2 Faktorët ψ për urat rrugore

Veprimet (F) normalisht veprojnë të kombinuara, ose me vlerat karakteristike ose me vlera të tjera përfaqësuese që vinë si rezultat i zvogëlimit të vlerave karakteristike pas shumëzimit me faktorët e reduktimit të duhur ψ :

- ψ_0 për rastin kur duhet përdorur madhësia e një vlere kombinimi;
- ψ_1 për rastin kur duhet përdorur madhësia e një vlere të shpeshtë;
- ψ_2 për rastin kur duhet përdorur madhësia e një vlere pothuajse të përhershme.

Faktorët ψ_0 , ψ_1 dhe ψ_2 për urat e autostradës jepen në tabelën A2.1 të shtojcës A2 të SSH EN1990 dhe janë treguar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4.7: Faktorët e reduktimit ψ , sipas tabelës A2.1 të shtojcës A2 të SSH EN1990

Veprimi	Simboli	ψ_0	ψ_1	ψ_2	
Veprimet prej trafikut	gr1a	TS			
		UDL			
		Trotuar + Korsi biçikletash			
		grlb1 me një aks	0.00	0.75	0.00
		gr2 veprim horizontal	0.00	0.00	0.00
		gr3 veprime prej trafikut këmbësor	0.00	0.00	0.00
		gr4 veprimet prej turmës	0.00	0.75	0.00
		gr5 veprimet nga mjet i veçantë	0.00	0.00	0.00
Veprimet prej erës	F_{wk}	veprim i vazhdueshëm (gjatë shërbyeshmërisë)	0.60	0.20	0.00
		veprim kalimtar (gjatë zbatimit)	0.80	-	0.00
		F_w^*	1.00	-	0.00
Veprimet prej temperaturës	T_k	0.60	0.60	0.50	
Veprimet prej borës	$Q_{Sn,k}$ (gjatë zbatimit)	0.80	-	0.00	
Veprimet prej punimeve të zbatimit	Q_c	1.00	-	1.00	

4.6 Ngarkesat e trafikut - shpërndarja tërthore sipas seksionit të urës

4.6.1 Modelet e ngarkimit sipas SSH EN1992-2:2003

Modeli i ngarkimit LM1

Ky model ngarkimi parashikon ngarkimin e korsive, siç është treguar edhe më poshtë, me sistemin TS dhe UDL

Modeli i ngarkimit LM2

Ky model ngarkimi parashikon një aks të vetëm, i aplikuar në pozicione të veçanta i cili mbulon efektet dinamike të trafikut normal në elementë strukturorë me hapësira të vogla. Kjo skemë përdoret për verifikime gjysmë – lokale dhe lokale.

Modeli i ngarkimit LM3

Ky model ngarkimi parashikon një grup ngarkesash aksiale që përfaqësojnë mjetet e veçanta që mund të udhëtojnë në rrugë që lejojnë të kalojnë këto ngarkesa. Kjo skemë përdoret për verifikime të përgjithshme dhe lokale.

Në raste të veçanta dhe kur është e rëndësishme, modelet e mjeteve të kontrollit duhet të përcaktohen dhe të merren parasysh. Përcaktimi i këtij modeli të veçantë ngarkimi, duhet të hartohet dhe përcaktohet në Aneksin Kombëtar. Në mungesë të tij, dhe bazuar në rekomandimet e shumë autorëve, është zgjedhur mjeti i veçantë SV900.

Modeli i ngarkimit LM4

Ky model ngarkimi parashikon ato raste kur turma masive njerëzish kalojnë mbi urë. Ngarkesa e turmës së njerëzve (grumbullime të mëdha), shërben vetëm për verifikime të përgjithshme.

Sipas rekomandimeve të SSH EN1992-2:2003, do merren parasysh modelet e ngarkimit LM1, LM3 dhe LM4.

4.6.2 Llogaritja e koeficientit të shpërndarjes tërthore

Për të gjetur pozicionin më të pafavorshëm të ngarkimit të urës, llogariten ordinatat për secilin pozicion të modelit të ngarkimit, LM, duke përdorur formulat e hartuara për llogaritjen e koeficientit të shpërndarjes tërthore.

Siç jepet edhe në figurën e mëposhtme, meqenëse trarët e urës lidhen në drejtimin tërthor me diafragma, si metodë llogaritjeje e koeficientit të shpërndarjes tërthore është pranuar sipas metodës së shtypjes jashtëqendrore. Më poshtë jepen të dhënat dhe llogaritjet e kryera, si edhe skema e ngarkimit të projektimit, sipas korsive të projektimit.




Fig. 4.9: Ngarkimi i korsive sipas SSH EN1991-2:2003, LM1




Fig. 4.10: Skema e qarkullimit të korsive, ura që lidh M3 - U3,U4




Fig. 4.11: Ngarkimi i korsive sipas SSH EN1991-2:2003, LM1




